

## Procesverbal

*Nga Mbledhja II (e dytë) e rregullt për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 25.02.2026*

### *Rend Dite*

1. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e dytë të rregullt; dhe
2. Eventuale.

**Resul Fetahu:** Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, OSBE, të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së për vitin 2026. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë, ku i kemi dy pika të rendit të ditës dhe për seancë janë paraparë shtatë pika të rendit të ditës dhe pika eventuale. A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë kush është për rendin e ditës të KPF-së? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, a do dikush me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe procesverbalin e seancës së kaluar.

Vazhdojmë me pikën e dytë të shqyrtimit të materialit të Kuvendit, Raporti vjetor financiar për vitin 2025.

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë, i nderuari kryesues e kam një vërejtje shumë serioze ndaj teje, sepse kam pritë se ka mu bo shum më mirë me ty mirëpo po më vjen se jo. Unë kam kërkuar materialin në kopje fizike për arsye me ardhë ne me llaptopa siç kam ardhur unë nuk kemi kushte, sot i kemi mbi 120 faqe mi shfletue e në telefon nuk kam qysh. Më herët jam afër këtu kur më është dashur ndonjë dokument kam ardhur në shërbimin e kuvendit, por tash i nderuari dhe shumë i rrespektuar Suad Tosuni është bërë edhe një “boss” sikur Uzairi, sepse tash nuk i bënë as kopje delegatit. I kërkojë një kopje dhe thotë s’mundesh me bo kopje shihne se në çfarë gjendje e keni sjellë Komunën, që një të zgjedhurit të popullit nuk i bëhet kopja për arsye se nga seanca e kaluara unë kom dashtë një OJQ nga komuniteti shqiptarë dhe ai është prek me mu dhe më thotë jo që nuk të bëjë kopje por pa ardhë në zyre me më kërkuar falje, një delegatë i kuvendit komunal me i kërkuar falje një punëtori është për të ardhur keq, merrni masa se kryetarë edhe për ty vlenë kjo sepse unë po duhet me marrë llaptopin sot këtu po nejse. Shkojmë me pikën e rendit ditës sepse dua që t’ja bëjë një pyetje drejtorit të cilin nuk po e shohë këtu, sepse une e di që jam infermier dhe ai është i shkolluar për këtë punë edhe ku e qte në rend dite edhe me pas keq nuk është shumë problem. Deshta me pytë te kodi 13615 – furnizimi me ushqimë për kafshë, unë jam këtu qe 4 mandate dhe ushqimë për kafshë nuk kam parë dhe se dijë për cilat kafshë bëhet fjalë nëse ka mundësi? Tjetra, 13640 – furnizime pastrimi 24,111 euro nuk e kam të qartë, 14060-mirëmbajtja rutinore 34,851 euro, 14230 – shërbime për informim publikë afër 12,553 euro edhe më erdhë çudi 13490 – shërbimet e varrimit nuk ka për vitin 2024 dhe 2025, kur shkojmë pak më poshtë 13280 – janë mbeturinat 86,134 euro. Unë e kam një pyetje për kryetarin sepse i kam disa informata se disa fshatrave në kohë fushate ju ke paguar mbeturinat, nëse është e vërtet cilat fshatra janë ato dhe sa

pare keni dhënë prej taksapaguesve dhe a ju keni premtuar për këto 6 muajt e parë të 2026, kam informata se 9 fshatra nga participimi parët e kuvendit paguhen ndërsa ne qytetarët tjerë bëjmë pagesën dhe prej parave tona ju bëhet pagesa edhe qytetarëve tjerë. Shkojmë pak më poshtë 22298 – tek subvencionet dhe transferet, këtu është për çudi pagesa për shërbimet e varrimit për 2024 janë bërë afër 12,000 euro qetash po du me pytë drejtorin a ka bërë ndonjë gabim? Dhe ne fund një pyetje, këtu te shpenzimet kapitale kodi 32100 – toka, veç toka është 30,000 euro nuk e kam kuptue këtë. Ju faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje për të gjithë, më vjenë mirë se delegati i ka bërë disa pyetje me vend paraprakisht edhe pse KPF-ja do të ishte mirë që me fut në rend të ditës që me mund edhe nesër me ju dhënë sqarime kështu për mos mi duplikue sqarimet pasi që i ka bo sot, unë do të mundohem t'i jap sqarime dhe më vjenë mirë që për herë të parë bëri pyetje dhe nuk komentojë si dhe është mirë që për çdo shpenzim që ka rënie apo ngritje të parashtrihen pyetje se pse ka ndodh këto ndryshime.

Unë po filloj prej shpenzimet e transportit brenda vendit dihet që janë nxënësit dhe këtë e kemi shpjeguar disa herë, sa i përket pyetjeve t'ua, ushqimi për kafshë këtë rastë e kemi paguar shoqatën e gjuetarëve për të intervenuar në mënyrë që të ushqehen arinjët dhe kafshët e egra gjatë dimrit, sa i përket te Toka është pagesa që është bë Bashkësisë Islame për shkollën e Zgatarit që e kemi ble atë vend dhe tani jemi detyruar që ta paguajmë në disa rata, dhe më tutje do të kemi rastin ta paguajmë edhe një 30,000 euro. Shpenzimet e varrimit ju e dini që këtë mvitë ne kemi bërë rritjen e këtyre shpenzimeve 200 nga sa ishte 150 tash 200 i merr bashkësia islame me TVSh prej 18 % në total 250 euro bëhet pagesa për një varrim. Prandaj këto kanë ndikuar në rritjen në krahasim me vitin paraprak. Për mbeturinat është transparent në webfaqe për ato 8 fshatëra do t'i fusim në sistem dhe përfundimisht komuna e Dragashit do të jetë e mbuluar ne sistem të grumbullimit të mbeturinave. Ju e dini që disa fshatëra kanë hezitue dhe Komuna ka ndërmjetësue ne mes të atyre fshatrave dhe kompanisë dhe tash gradualisht edhe ato fshatra do të futen në sistem të pagesës së mbeturinave dhe njëherë e përgjithmonë do të zgjidhet ky problem.

**Artan Loshaj:** Kryetarë veç deshta me ditë sa është shuma për ato fshatëra, mirë shumë ke bërë marrveshje të mbështesim si opozitë mirëpo trego a ke bërë pagesë në emër të atyre fshatrave në ekoregjion dhe sa është shuma, për gjashtë muaj të 2026 deri ti futish në sistem se kjo ishte në kohë fushate dhe bravo të qoftë, tani na trego pse edhe për gjashtë muaj, pse atyre fshatrave po ju bënë pagesë e p.sh: tjera fshatra si Kuki, Brodosana e ne bëjmë pagesa, e ju prej parave të komunës keni bërë pagesë për gjashtë muaj, sa është shuma për 2025 dhe sa do të jetë për gjashtë muaj të 2026?

**Bexhet Xheladini:** Përshëndetje për të gjithë, desha t'a bëjë një sqarim sa i përket pagesës së mbeturinave të disa fshatrave që mbi 20 vjet e më shumë nuk kanë qenë të kyçura në sistemin e grumbullimit të mbeturinave përmes ekoregjionit. Ne edhe pse kemi bo përpjekje të vazhdueshme që ti bindim këto fshatëra të kyçen në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, këto fshatëra nuk kanë pranuar atëherë unë kam biseduar me kryeshefin e Ekoregjionit dhe kemi bërë një marrëveshje që do të thotë do t'a bëjmë pagesën ne Komuna këtu kanë qen dy fshatëra të opojës dhe më duket gjashtë të gorës dhe kjo ka qenë shumë më herët se zgjedhjet nuk të bëjë fare me zgjedhjet lokale po mendojë. Ne e kemi bë këtë me qëllim që me pa se sa është mirë që ato fshatëra të futen në sistem të grumbullimit që ta kenë ambientin e pastër dhe që mbeturinat mos ti gjuajnë kudo dhe do të vazhdojmë me pagesën edhe këtë vitë në mënyrë që nga janari i vitit të ardhshëm kanë me bo pagesën vetë fshatarët apo amëvisërit.

**Uran Halimi:** Përshëndetje për të gjithë, unë e përgëzojë kryetarin për këtë stimulimin e këtyre fshatrave dhe në të ardhmen t'i stimulojë këto fshatëra që të bëjnë pagesën, meqenëse nuk është shumë

e madh për njëmijë euro jepi edhe njëmijë tjera dhe bonja bonus krejt qytetarëve të komunës sonë për këtë vitë, meqenëse andej janë 6 fshatëra edhe dy këndeje të kisha propozue që krejtë komunës me ja heq këtë pagesë për këtë vitë edhe ashtu parat e qytetarëve janë s'besojë që duhet me tu dhimtë kaq shumë. Faleminderit!

**Resul Fetahu:** A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe një abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë, Propozim vendimi për formimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në teren dhe zgjedhjet e këshillave lokal. A do dikush me e marrë fjalën?

Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë.

Vazhdojmë me pikën e katërt, Propozim vendimin për themelimin e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore?

A do dikush me e marrë fjalën?

**Artan Loshaj:** Kryesues, ky Propozim vendimi për themelimin e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, sa bukur këta tre emëra po i rrijnë kryetarit, sikur ato tri shkronjat e arta të UÇK-së, me numër 2 – Behar Brenolli, me numër 8 – Uzair Hamza dhe me numër 10 i nderuari z.Ademi, këta i ka në çdo komision duhet me qenë prezent pa këta nuk bëhet ky komision, unë nuk e dijë kryetari çfarë dashni të madhe ka për këta, po këtyre treve po e propozojë me numër 11 edhe Suad Tosuni t'ia kthejë borxhin në mënyrë që të kompletohet kjo listë.

**Lindita Kozmaqi Piraj:** Përshëndetje për të gjithë, përtej shakas së Artanit, kjo është një rregullore prej nivelit qendror, na kemi funksionu qe 10 vite si mekanizëm koordinues komunalë për mbrojtjen nga dhuna në familje, mirëpo tash ka qenë në bazë të një memorandumit të mirëkuptimit që e ka nënshkru kryetari me gjithë anëtarët që janë nën ombrellën e Komunës që janë edhe këtu të pranishëm edhe atyre që janë jashtë ombrellës së Komunës e që janë institucione relevante kundër dhunës në familje. Tash me rregulloren e re që nga gjysma e vitit të kaluarë më duket ka ardhë që këtë mekanizëm duhet me sjellë me vendim të kryetarit dhe me miratim të asamblesë komunale, andaj ju lusë që nesër ta bëjmë miratimin e këtij mekanizmi dhe të vazhdohet puna ashtu qysh kërkohet me rregullore që ta udhëheq tash e tutje kryetari. Çdo anëtarë i këtij mekanizmi është i propozuar sipas rregullores dhe pozitës që e ka dhe pastaj vjen edhe emri.

**Artan Loshaj:** Unë nuk e kisha që nuk është me rregullore ose që nuk është me vendim as te pagesa, veç deshta me ja kthye borxhin Suadit, unë dola që me i thënë që shumë bukur po rrinë si tri shkronjat e arta të UÇK-së, Uzairi, Behari edhe Ademi, po për me ju bashkangjitë këtyre UÇK-së edhe Liria Ka Emër edhe dhashë edhe një propozim Suadin, unë nuk e kisha tek pagesa.

**Resul Fetahu:** A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, një kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Para se të kalojmë te pika e radhës kryetari e ka fjalën.

**Bexhet Xheladini:** Këtu prej 15 anëtarëve apo sa janë në listë 18 vetëm dy janë nga komuniteti por nuk është keq që në vend të një OJQ-së me fut edhe Suadin, ne në seancën e nesërme konsulltona edhe me bazën ligjore, nëse ka mundësi edhe e futim në emër të OJQ-së.

**Suad Tosuni:** Përshëndetje për të gjithë, faleminderit për nominim nga ana e deputetit Artan Loshaj duke pas parasysh që ky komitet nuk paguhet OJQ – Renesansa nuk e pranon nominimin, ju faleminderit!

**Resul Fetahu:** Vazhdojmë me pikën e pestë, Propozim vendim për shpalljen e listës së përgjithëshme

dhe të veçantë të pronës së paluajtshme komunale, a do dikush me e marrë fjalën?

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje për të gjithë! Lista e përgjithshme është prej 170 pronave të cilat i posedon Komuna e Dragashit, një pjesë e tyre është e dhënë nëpërmjet ankandit publik ndërsa një pjesë me kontratë nën një vit dhe një pjesë duhet të ekzistojnë si të inventarizuara që janë në posedim të komunës së Dragashit, që në momentim kur kemi nevojë mi dhonë në shfrytëzim ose kur shpreh dikush interes. Kësaj radhe, një numër prej tyre nuk kanë interes, janë si të tilla të regjistrueme por askush nuk është paraqit, diku nëpër fshatëra i kemi disa hapësira që nuk shpreh askush interesim dhe pjesën tjetër që parashohim këtë vit ta japim është lista e veçantë dhe ju jeni to e pa edhe ato parcelat të cilat i kemi regjistrueme dhe janë në listën e veçantë që pritet që këtë vit t'i qesim në dhënie në shfrytëzim nëpërmjet ankandit ku ju delegatët do të caktoni komisionin edhe rregullat për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave. Unë besoj që kjo është një punë e cila bëhet në vazhdimësi, është me rëndësi që këto të qiten të miratohen dhe të kthehen si të ligjshme pastaj të shpallen në webfaqen e Komunës dhe pastaj të na lejohet mundësi e ndjekjes së procedurës tjera të cilat janë të parapara sipas ligjit.

**Artan Loshaj:** I nderuari drejtor, qe katër vite na ke sjell Copy-paste këto materijale, në seancën e fundit kur e kemi votue na ka ardhë negativ prej MAPL edhe arsytimin e kije, në arsytim thotë që lista e pronave të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim duhet të ketë të dhënat kadastrale, qëllimin, destinimin etj. ndoshta e ke lexue. Po më vjenë mirë që disa përmirësime i ke bo këtu, por unë të kam kërkuar që edhe në seancën e parë që ti përmirësosh disa gabime si p.sh.: me nr.36 e kije prap pa metër katror prap ka me ta kthye Ministria qysh po mendoni se po ju kqzrin politikisht me llup pastaj nr.87, nr.110 etj. i kije dikund 12 parcela pa m2 hiq, a ske mund me bo këtë përmirësim, edhe kur po thushë që s'janë të interesuar, t'i katër vite ke thënë se ka shumë të interesuar.

**Qamil Kolloni:** Këtë listë e përgatit Drejtorja e Urbanizmit, Shërbimi Pronësoro-Juridik. Lista e përgjithshme nënkupton pronat të cilat na i kemi dhe m2 në momentin kur shprehet interesi ju e dini që edhe objektet të cilat janë dhënë para ardhjes në pushtet nuk kanë pasur numër të vetë dhe jemi detyruar që t'i ndajmë t'i qesim gjeodetët që të bëjnë matjen dhe ta qesin edhe një numër, t'i regjistrojmë dhe t'i japim në shfrytëzim. Ndërsa kur është momenti për dhënie në shfrytëzim duhet t'i ketë të gjitha detajet është ligji i cili i parasheh këto. Deri sa nuk nënshkruhet kontrata kurgjo diskutabile nuk ka, në momentin kur të nënshkruhet kontrata qitet edhe këtu në Kuvend qitet nr. i parcelës dhe m2 dhe qiten të gjitha të dhëna që janë të parapara nga ajo pjesa të cilën e kemi. Në qoftë se kërkohet një hektar në rudinën e Kosavës, nuk do të thotë të jepet komplet Rudina sa është e regjistruar, po për atë bëhet matja, bëhet ndarja, nuk janë bo këto matje nga sekto gjeodezisë dhe tash nuk ekziston por si parcelë edhe si pronë ekziston. Momenti kur shprehet interesi nga Komuna dhe qytetari atëherë definohen të gjitha. Prandaj parcelat të cilat i kemi te lista e veçant janë parcela të detajuara. Sa i përket copy-paste unë e di që deri sa kam ardhë në pushtet unë në webfaqen e komunës së Dragashit nuk kanë qenë të publikuara kurr pronat komunale, merre kqyre në vazhdimësi është gjetë një listë nën tavolinë të cilën e kanë përdor për shantazh shërbimi i PDK-së dhe për herë të par në vitin 2022 – 2023 në mars i kemi bo publike këto prona.

**Artan Loshaj:** Më falë drejtor që të bëra pyetje po kjo nuk qenka në lëmin tënde sepse t'i e bënë edhe pak avokatin, t'i e dinë se ku ta qesë unë, pak pe luan rolin e shefit të urbanizmit, Behari përzihet në urbanizëm por edhe ti ja ke nisë kapak mu përzie në urbanizëm. Unë PDK-në e akuzova edhe unë dhe të mitë nuk po i amnestojë, kanë qenë edhe më të këqinjë se ju po edhe për atë kemi humb, shumë e thjeshtë është. Por mos më thuaj mua se është kullotë apo Rudinë e Xërxes këtu po të shkruan Tokë për Biznes në Dragash, tjetra Lokal Afarist, nuk është Rudina e Xërxes kjo. Ose fshije krejt ose qitja numrin

mos na bënë politikë tash jo nën tavolinë jo shatntazh dihet kush, mos drejtor mos të hyjmë andej se spo due këtu se dihet kush është për shantazhe këtu, le shantazhin e PDK-së, na t'i paskemi lënë ty nën tavolinë kur të vjenë ti ke mi gjetë dallaveret tona..

**Uran Halimi:** Kjo puna e matjeve, unë e kuptojë ka qenë dimër tash edhe kenë përtu me dal mi matë por në pranverë besoj Artan që i masin. Një pyetje kështu, ka qenë një listë e uzurpatorëve të komunës kur të kishte pyetur Jeta Xharra i nderuari kryetar, a është publikuar te transparenca që thaje në webfaqe ti drejtor lista e uzurpatorëve të Komunës, se ju ka pyetë Jeta Xharra më herët, apo publikohet ose a ka mu publikue apo keni harrue, ju faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Unë si drejtor, një listë të tillë nuk e kam pas në dorë, nuk e kom bo publike as sedij ku është publike dhe çka pyetën Jeta Xharra por edhe disave që pas orës 12 ju del gjumi nuk mundi mi dijtë ëndrrat e tyre se çka shohin dhe ku me i gjetë ato lista me j'au sjell. Një gjë e tillë nuk e dijë që ekziston në Komunë ose në ndonjë sektor të Komunës, s'kam informacione të tilla, ju lutem për këto informacione është prokuroria, është gjykata e keni rrugën e hapur dhe kërkoni ata uzurpatorët.

**Uran Halimi:** Gjumi drejtor disave ju del pas orës 12 por ty nuk po të del hiq! A je to kuptue se ti je ai drejtori më i afti që i dinë krejt gjërat mirëpo tash nuk po e dinë listën, e dinë shumë mirë, se kur vjen puna për mu mbrojtë ju ose nuk dini ose t'ja lemë prokurorisë si te rasti i seancës fundit që deshtët me ja lënë të gjitha prokurorisë por prokuroria i ka ato të gjitha. Te gjumi, mos kalo në personale, është hera e fundit të lutem, a çohem unë në ora 12 apo nuk çohem hiq ajo është çështja ime personale edhe çysh çohem, por nëse kije nevojë unë çohem kur duesh ti veç më trego. Mos kalo në personale, unë nuk po të pyes se kur je çue ti se hiq nuk më intereson ai muhabet edhe nëse hiç nuk çohesh a po kupton? Ne jemi këtu për me bo politikë jo para 12 pas orës 12 se unë për ty jam i zgjuar kur të duash ti, vetëm më trego.

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e 6 të rendit të ditës. Miratimi i planit komunal për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2026-2028.

**Artan Loshaj:** Pika 6 Draft Plani për Riintegrim të Qëndrueshëm, ky është një debat shumë i madhë kryesues, sot kam pas qef lojtarin kryesor të këtij tenderi se tender është ky z.Uzair Hamzën me pas këtu sepse kryetari e amnistion i thotë shko mos hajde hiq kuse e kije deni punë. Pse kryetarë disa drejtor të SDU-së asnjëherë nuk të vijnë këtu? Nesër ditën e seancës a ka mundësi me qenë i pranishëm edhe z.Uzair Hamza në seancë? Unë e dijë që edhe Uzairin e kije për performancë po nesër këtij kam me ja bo disa pyetje e përgatite. Më herët me të riatdhesuarit me ne po të foli por edhe pak me ju se ne ja kemi shtruar zhavorrin e ju asfaltin për me korruptue e me shfrytëzue këtë riatdhesimin. Po të pyesë kryetarë që për këto katër vite a ka qenë një familje apo një person i riatdhesuar apo që ka bo riatdhesim të qëndrueshëm, është kthye prej Beogradit, Austrisë, Zvicrës etj. Prej Maqedonisë është kthye në Dragash, ka marrë subvencion i kemi ndërto shtëpi, i kemi dhënë blea si dhe maqineri për me bo bozë dhe është i qëndrueshëm sepse e ka biznesin këtu. Uzair Hamza kur i duhen për zgjedhje, unë prej këtu i bëjë ftesë prokurorisë me hetue atë bashkë me disa persona të tjerë të komunës, në qoftë se nesër na tregon Uzair Hamza se një person i vetëm ka bo riatdhesim të qëndrueshëm në Dragash, në ora 7,30 vjenë Adio toursi këtu kur vjen puna e zgjedhjeve i bënë rend këtu se kom me ju dhënë shtëpia banesa e kemi me ju dhënë subvencione dhe te zyra e fitimit bëhet rendi i madhë sikur në ndonjë furrë buke që Uzairi ka me ju ndihmue për zgjedhje në ora 7.30 ose 8 i kthen për në Beograd, Novi Sad, Maqedoni, Malë të Zi. Mos e lejo kryetarë me e keqpërdor se unë të kam thënë edhe më herët këtu se Uzari Hamza ka bënë riatdhesim veç në dokumenta edhe personi i cili ka qenë i akuzuar për krime lufte dhe është i

dënuar, Uzair Hamzën e kije shpiunin dhe mbeturinën më të madhe serbe këtu edhe po ta bëjë një kërkesë një apel zyrtarë ndale pak kryetar Uzairin edhe drejtorin e shëndetësisë se e dinë çfarë lajka kanë deshtë me më bo por i kam kaluar këto sfida, kam me më humb durimi po të kallxojë se nuk po i kërcënojë por kur kam kaluar kufirin më pyeti polici a je ti delegatë? unë i them po, thotë ti shumë po fletë se krejtë këto informatat në Beograd i çon Uzairi. Por po ju kërkojë këtyre që mos të mirren me mu se ndoshta një ditë më humb durimi shumë janë duke u marrë me thashethemet e mija, kanë deshtë me ma bo një komplotë në spital por i kalova ato kriza dhe nesër kërkojë që të jetë prezent sepse këto pare këto mjete t'i keqpërdoren në mënyrën më të keqe të mundshme edhe kam kërkuar me largue atë por ti e ke të ledhatuarin tënd.

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e 7 të rendit të ditës, propozimi i dy delegatëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit për përfaqësim në Asociacionin e Komunave të Kosovës. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e 3 të KPF-së, pra me pikën eventuale. Para se me vazhdue, ju njoftojë se e kemi një kërkesë për përkrahje materiale nga qendra për punë sociale për familjen strehuese për bashkshortet Agim dhe Selvina Skeraj nga fshati Rrenc që kanë kërkuar në vlerë prej 1500 euro që t'i ndihmohet në Komitet për Politikë dhe Financa, a do dikush me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe kjo kërkesë. Vazhdojmë me pikën eventuale.

**Artan Loshaj:** Kryetar i kam ja dy pyetje. Vitin e kaluar, rreth muajit gusht, keni marrë një vendim dhe e keni dërguar në zyrën e pranimit që ata të cilët kanë nevojë për mjete për sëmundje të mos dorëzojnë dokumente, përveç personave që kanë kancer të gjirit. Për mua, kjo ka qenë e padrejtë dhe jo e mirë, dhe shpresoj që këtë vit nuk do ta përsërisni, sepse përbën diskriminim. Në komunën e Dragashit nuk ka vetëm raste me kancer të gjirit, por ka edhe persona që vuajnë nga lloje të tjera të kancerit. Ky ka qenë një diskriminim, dhe unë e di kush e ka bërë, por kjo nuk është me rëndësi.

Pyetja e dytë, për Bashkësinë Islame që është e ndarë në të Gorës dhe Opojës, është rasti i parë që kam ndërgjue që në një komunë kaq të vogël mu nda bashkësia islame, më trego qysh ka rrjedh kjo ndarje dhe me sjell drejtorja që kanë qenë të propozuar nga Lista Serbe për zëvendësministër, kryeministri Kurti i ka largue kurse ti me urdhëra të Beogradit e ke bërë drejtor të bujqësisë, përveç kësaj është qytetarë i komunës së Prizrenit, lista e Adem Hoxhës me siguri ka të tjerë të shkolluar, që e ka djalin këtu le t'i bjerë të tjerë këtu sepse na pak kemi këtu qytetarë të Dragashit e tash po na bjerë qytetarë prej Prizrenit që e dinë bujqësinë, sepse ky ka ecë vetëm në kubëza dhe nuk e dallon lopën prej gomarit dhe me e sjell këtu për drejtor të bujqësisë vetëm ti e bënë këtë kryetarë me direktiva. Mos kryetarë se një ditë do t'a ndajmë edhe një komunë se një pak e kanë.

**Bexhet Xheladini:** Vitin e kaluarë ka qenë thirrja e hapur për të gjitha llojet e sëmundjeve duke përfshi në aspekt të posaçëm kancerin e gjirit sepse ka qenë një vendim i asmblesë komunale dhe fushata më e madhe kudo në botë bëhet për kancer të gjirit e kurse për kancere tjera më pak, për atë ne e kemi bërë këtë si prioritet dhe e kemi caktuar shumë. Vitin e kaluar kanë aplikuar diku 500 aplikant, për ndihma për mjete, sëmundje si dhe çështje të tjera, në momentin kur janë shpenzuar mjetet dhe më nuk ka pas mjete për sëmundje të tjera, atëherë unë e kam sjellë një vendim që do të thotë zyrja e pranimit të pranoj vetëm kërkesa për kancer të gjirit dhe pas asaj janë pranue edhe dy kërkesa për vitin e kaluar dhe ka përfundue. Kështu që, këtu nuk pas kurrëfarë diskriminimi ndaj askujt dhe janë shqyrtue 500 kërkesa

ku prej tyre 495 kanë qenë përfitues, pra vetëm 5 ose 6 janë refuzue edhe atë vetëm se kanë qenë anëtarë të dy të së njëjtës familje ose nuk i kanë pas dokumentat e mjektu të vitit kur është parashtrur kërkesa. Sa i përket Bashkësisë Islame, po të kisha qenë në kryetarë në atë kohë kur është bërë ndarja nuk e kisha lejuar mu nda, ka qenë para meje një kryetarë tjetër i cili e ka miratuar edhe e ka ndarë pastaj këtu edhe e ka pranuar Bashkësia Islame e Kosovës dhe ata kanë vendim dhe janë legjitim. Po me pas qenë unë, jo që jam trimë por kisha biseduar në pafundësi vetë që mos të ndahen sepse tash kjo ndarje edhe mu po më bënë problem sepse edhe mu po më duhet me i vizitu të dy bashkësit, me i thirrë për iftarë të dyjat sepse po duhet me i humbë dy ditë. Megjithatë të dyja punojnë shumë mirë, si dhe me mua të dy bashkësitë bashkëpunojnë dhe unë do t'a vazhdojë bashkëpunimin deri sa të janë të pranuar nga institucionet e Republikës së Kosovës. Uroj që një ditë prap të bashkohen unë jam përkrahës që ata prap të bashkohen. Sa i përket drejtorit, pasi që e kam fituar mandatin e dytë si kryetarë ne kemi koalicion pas zgjedhor me JGP-në gjë që e keni pas edhe ju. JGP është parti kosovare e regjistruar dhe legjitime, Adem Hoxha është deputet i parlamentit të R.Kosovës kështu që çka të foli më shumë vetëm gaboje. Unë Adem Hoxhës ja kam vënë një kushtë, që drejtorat që i propozon të jenë me fakultet vetëm kaq, drejtor i bujqësisë është një ekspert dhe një person me përvojë ka edhe përvojë në qeverisjen e institucioneve qendrore edhe rrjedh nga një familje patriotike në Prizren. Personi në fjalë me mua bashkëpunon i kryen detyrat dhe obligimet, unë nuk punojë në institucionet e sigurisë për me ditë çka bënë ai person natën, mua më intereson se çka bënë ditën dhe është një njeri jashtëzakonisht i mirë dhe kompetent për atë drejtorin, ju faleminderit!

**Artan Loshaj:** Kryetar, unë e di që di duash që të rrihë në pozitë pavarësisht se kush dhe qysh të sjell emëra, por unë këtu e kam një dokument zyrtarë këtu edhe mos thuaj ditën apo natën sepse këtu është një dokument zyrtarë ku prej kësaj liste ka qenë zëvendësministër, unë e njohë para teje që 20 vite, një qytetarë që nuk ka dokumente të Dragashit, qysh me shkue unë mu bo drejtor në Gjakovë, nuk e kapën. Për Uzairin që ta bëra një kërkesë, zyrtarishtë ta kam bërë një kërkesë merru me Uzairin, në procesverbal e kije, publikisht e kije me inçizim e kije merru me Uzairin edhe Behar Brenollin në raport me mua. Kam dëshirë mu ulë me ty kryetar, Uzairin edhe Beharin me diskutue këtë problem se shumë po merren me thashetheme, ju faleminderit!

**Resul Fetahu:** Faleminderit! A do dikush tjetër me marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e mbylli këtë takim të KPF-së, shihemi në seancë! Faleminderit!